



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020

Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollit 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 11, të datës 28.03.2020, nga Kompania **BRUPHARM SH.A**, me seli në Fushë Kosovë, me adresë: Nëna Terezë me person përgjegjës **Albulena Miftari**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **BRUPHARM SH.A** me seli në Fushë Kosovë, rruga Nëna Terezë.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Morfine HCl, morphine, tablet 10mg: €8.32
2. Soro Fiziologjiko, sodium chloride, solution for infusion, 9g/1000ml: €0.75
3. Terbinafina Basi, terbinafine, cream 10mg: €3.00
4. Dimidon, ibuprofen, coated tablet, 400mg: €3.36
5. Clotrimazole Basi, clotrimazole, cream 10mg: €1.78

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **BRUPHARM SH.A** me seli në Fushë Kosovë, rruga Nëna Terezë, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

- 1.Morfine HCl, morphine, tablet 10mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €26.00
- 2.Soro Fiziologico, sodium chloride, solution for infusion, 9g/1000ml, për të cilin ka aplikuar për çmimin €0.75
- 3.Terbinafina Basi, terbinafine, cream 10mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €3.00
- 4.Dimidon, ibuprofen, coated tablet, 400mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €3.50
- 5.Clotrimazole Basi, clotrimazole, cream 10mg, për të cilin ka aplikuar për çmimin €3.78

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/ origjinës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
Morfine HCl	morphine	Tablet	10mg	30 PCS	26.00	AL-8.32	8.32	Për shkak se çmimi është vetëm në një vend referent atëherë për vendosjen e cmimit është marë për bazë vendi i origjinës.
Soro Fiziologico	Sodium chloride	Solution for infusion	9g/1000 ml	500ml	0.75	0.75	0.75	Në mungesë të çmimeve në shtetet primare dhe sekondare cmimi është vendosur sipas cmimit ne vendin e origjinës.
Terbinafina Basi	Terbinafine	Cream	10mg	1 PCS	3.00		3.00	Në mungesë të çmimeve në shtetet primare dhe sekondare cmimi është vendosur sipas cmimit ne vendin e origjinës / cmimit të deklaruar nga bartësi i MAH


Dimidon	Ibuprofen	Coated Tablet	400mg	60 PCS	3.50		3.36	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Ibuprofen Mylan.
Clotrimazole Basi	Clotrimazole	Cream	10mg	1 PCS	3.78		1.78	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të krahasimit me origjinator Canesten.

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendrike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare
3. Etrit Tetova AKK anëtar
4. Amir Keka FSSH anëtar
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar
6. Dardan Nallbani MTI anëtar
7. Blerta Kika MF anëtare



Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.